



Ср.Лр.№

1030/24
Dl

01 MAR 2024



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.10/2019), nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/20 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 28.02.2024, merr këtë:

VENDIM Nr.13/2024/KG

për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurës së dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për lokalet në Suhadoll

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurës së dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për lokalet në Suhadoll.

Neni 2

Për anëtarë të Komisionit vlerësues emërohen personat e mëposhtëm:

Bojan Stojanović	(i propozuar nga kryetarja e komunës).
Svetlana Đokić	(e propozuar nga kryetarja e komunës).
Miloš Dimić	(i propozuar nga Kuvendi i komunës).
Marko Arsić	(i propozuar nga Kuvendi i komunës).
Bojana Mitić	(e propozuar nga sektori joqeveritar).

Neni 3

Komisioni do ta kryejë punën e tij në përputhje me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit



Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević